



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË**

Numri i lëndës: 2024:135117

Datë: 12.07.2024

Numri i dokumentit: 05932144

**PPP.nr.80/24**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-Dega e Gjykatës në Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, gjyqtaren Hatixhe Begaj me zyrtaren ligjore Albane Morina, në çështjen përmbarimore të kreditorit F. H., punëtor pranë debitorit, të cilën e përfaqësojnë të autorizuarit avokat Bekim Sfishta dhe avokat Jeton Osmani, kundër debitores Komuna e Malishevës, për pagesën e borxhit në shumën prej 1,476.00 euro në emër të shujtave ditore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të paraqitur me datë 05.10.2023, kundër urdhrin përmbarimor P.nr.897/23 të datës 25.09.2023, i caktuar nga përmbaruesi privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 12.07.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar** prapësimi i debitores Komuna e Malishevës, i ushtruar me datën 05.10.2023, kundër urdhrin për përmbarim P.nr.897/23 të datës 25.09.2023, i Përmbaruesit privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë.
- II. MBETET NË FUQI** urdhri përmbarimor P.nr.897/23 i datës 25.09.2023, i përmbaruesit privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, për shumën e borxhit prej 1,476.00 euro.
- III. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e kreditorit për kompensimin e shpenzimeve lidhur me përgjigjen në prapësim në shumën prej 156.00 euro

**A r s y e t i m**

Në bazë të propozimit për përmbarim të parashtuar me datën 25.09.2023, nga kreditori F. H., punëtor pranë debitorit, përmbaruesi Privat Afet Mjeku me seli në Prishtinë, ka nxjerrë Urdhrin përmbarimor numër P.nr.897/23 të datës 25.09.2023, me të cilin ka caktuar përmbarimin në bazë të Vendimit të kuvendit Komunal të Malishevës nr.02/464 të datës 02.12.2020 i miratuar

me datë 30.11.2020, në emër të borxhit për shujta ditore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, i cili vendim paraqet bazë për lejimin e përmbarimit.

Kundër urdhrin për caktimin dhe lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor prapësim ka paraqitur debitorja me datën 05.10.2023, duke e kontestuar urdhrin përmbarimor me arsyetimin se nuk është mbështetur në dokument të besueshëm, nuk përmban shumën e mjeteve dhe nuk përmban titull përmbarimor në bazë të nenit 29 të LPP-së, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i Komunës së Malishevës dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor si i pabazuar, pasi që i njëjti nuk është i mbështetur në bazë të dokumentit të besueshëm sipas dispozitave të LPP-së.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Kreditori ka paraqitur përgjigje në prapësimin e debitorit, me të cilin i ka kundërshtuar pretendimet e theksuara në prapësim si të pabazuara për faktin se përmbarimorja e prapësimin të debitorit nuk përmblot asnjërin nga kushtet sipas nenit 71 të LPP-së, pastaj debitorin nuk e ka kundërshtuar borxhin, gabimisht në prapësim ka theksuar se vendimi administrativ nuk është titull përmbarimor, sa i përket shumave ato janë të gjitha të cekura për secilin kreditor, debitorin nuk e ka përmblot obligimin e tij dhe debitorin prapësimin e ka paraqitur vetëm sa për ta zvarritur procedurën.

I ka propozuar gjykatës që të bie aktvendim me të cilin refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe urdhri për caktimin e përmbarimit të mbetet në fuqi.

Shpenzimet për përgjigje në prapësim i ka kërkuar në shumën prej 156.00 euro, si dhe shpenzimet tjera të procedurës.

Gjykata, pas shqyrtimit të propozimit të kreditorit, urdhrin për përmbarim, prapësimin të debitorit, përgjigjes në prapësim, si dhe shkresave tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se:

*-Prapësimi i debitorit është i pabazuar.*

Gjykata nuk ka caktuar seancë gjyqësore, ngase të dhënat e parashtruara në propozimin për përmbarim si dhe dëshmitë e bashkangjitura, janë të mjaftueshme për të vendosur rreth kësaj çështje juridiko përmbarimore.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigja në prapësim si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Debitorin nuk ka ofruar asnjë provë me shkrim, siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të Ligjit të Procedurës Përmbarimore (LPP), sipas të cilit: “*Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësim duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet*”, me të cilën do të mund të argumentonte pretendimet e cekura në prapësim apo se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, në të cilat bazohet prapësimi i palës.

Gjykata ka vlerësuar se urdhri P.nr.897/23 i datës 25.09.2023 i përmbartuesit privat, është i ligjshëm dhe i rregullt dhe se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës përmbartimore për shkak se në këtë rast përmbartuesi privat e ka lejuar përmbartimin në bazë të titullit përmbartimor, Vendimit të Kuvendit Komunal të Komunës së Malishevës nr.02/464 të datës 02.12.2020, i miratuar me datë 30.11.2020, i cili është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm në përputhje me nenin 24 par.3 dhe 38 par.1 të LPP-së.

Sipas nenit 24 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se: *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”*, ndërsa sipas nenit 38 paragrafi 1 përcaktohet se: *“Propozimi për përmbartim duhet ta përmbajtë kërkesën për përmbartim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbartimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbartimi, kërkuesi i përmbartimit dhe debitori, adresa e vendbanimit–vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbartimi, objekti i përmbartimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbartimit”*, po ashtu në bazë të dispozitave të nenit 144 par.1, nën par.1.2. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit nuk lejohet ankesa”*, ndërsa sipas nën par.1.3 është përcaktuar se: *“Një akt administrativ do të bëhet i ekzekutueshëm me njoftimin e palës, me aktin, kur sipas ligjit ankesa nuk ka efekt pezullues”*.

Vendimi i Asamblesë Komunale të Malishevës Nr.02/464 i datës 02.12.2020 dhe i miratuar me datë 30.11.2020, në rastin konkret është dokument përmbartues, kjo parashihet në nenin 22 paragrafi 1 pika 1.2 të LPP-së, e cila dispozitë përcakton se: *“Dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative”*, dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, e po ashtu i plotëson kushtet nga neni 24 paragrafi 3 të LPP-së dhe i përmban kërkesat nga neni 27 paragrafi 1 të LPP-së, me të cilin ku përcaktohet se: *“Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Ky vendim i Asamblesë Komunale të Malishevës nr.02/464, është kopje e vërtetuar (e noterizuar), është i plotfuqishëm dhe i përmbartueshëm, ndaj të njëjtit nuk lejohet ankesë, dhe se vendimi i përmendur si titull përmbartues deri më tash nuk është shfuqizuar, prandaj i njëjti juridikisht përfaqëson titull juridik të plotfuqishëm dhe të përmbartueshëm i cili është bazë juridiko ligjore e urdhrin të përmbartuesit privat për caktimin dhe lejimin e përmbartimit të propozuar nga kreditori.

Sipas vendimit të Ministrisë së Financave i datës 11.12.2020 me nr. prot.2199-1 me titull të lëndës “Konfirmimi i ligjshmërisë së akteve të komunës” i cili i është dërguar Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL), thuhet se vendimi i Komunës së Malishevës i miratuar me datë 30.11.2020 për lejimin e pagesës për shujta për të punësuarit e administratës (shërbyes civil dhe

zjarrfikësve) i pranuar në MPL me datë 04.12.2020 dhe i pranuar në Ministrinë e Financave (MF) me datë 08.12.2020, nuk i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë sipas rregullores QRK 10/2019, të cilat janë në shtojcën II.

Gjykata i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të debitorit por të njëjtat kanë mbetur në nivelin e pretendimeve të pabazuara dhe të paargumentuara.

Lidhur me shpenzimet e kërkuara, gjykata vendosi si në pikën -III- të dispozitivit të këtij aktvendimi ku kërkesa për kompensimin e shpenzimeve lidhur me përgjigjen në prapësim është refuzuar, për shkak se e njëjta nuk konsiderohet parashtresë në kuptim të nenit 99 të LPK-së, nenit 6.1 të OAK-së, si dhe nenit 2.4 të UA Nr.01/2017 të datës 15.03.2017 për unifikimin e taksave gjyqësore, si dhe pikës 4 të konkluzioneve për unifikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, e datës 16-17 mars dhe 26-27 qershor 2023.

Nga të cekurat më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të dispozitave të nenit 73 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore.

**Gjykata Themelore Gjakovë, Dega e Gjykatës në Malishevë**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil**  
**PPP.nr.80/24, datë 12.07.2024**

**Gjyqtarja**  
**Hatixhe Begaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.